



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:027221

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05557175

**PKR.nr.905/2020**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË /DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues (KTGJ) dhe gjyqtarët Fatime Dërmaku e Ertan Sejfulla - anëtarë të trupit gjykues (ATGJ), me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarit I.B., i akuzuar për shkak të veprave penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK; Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 321 par. 1 të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I.nr.44/2020, të datës 21.09.2020, pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datat:05.01.2023; 02.06.2023; 05.09.2023; 12.10.2023, 14.12.2023; 08.02.2024; 19.03.2024 dhe 27.03.2024, në të cilin kanë qenë të pranishëm: prokurori i shtetit Armend Hamiti; i dëmtuari A.H. me përfaqësuesen e tij av. Merita Stublla Emini me autorizim; i akuzuari I.B. me mbrojtësen e tij av. Lendita Keqekolla-Gashi me autorizim dhe dëshmitarët: R.G.; P.Sh.; G.Z.; V.T. dhe M.L., pas shqyrtimit gjyqësor, me datë 29.03.2024 mori dhe publikisht, shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari I.B.**, i biri i S. dhe V., e vajzërisë H., i lindur me datë ..., në Prishtinë, Lagja ..., Rr. "...", numër ..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i punësuar –realizon të hyra mujore rreth 400-500 euro, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qenë nën masën e paraburgimit prej datës 22.02.2020 deri me datë 12.06.2020, pastaj nën masën e arrestit shtëpiak prej datës 12.06.2020 deri me datë 21.11.2020,**

## ËSHTË FAJTOR

**1. S e p s e:** me datë 22.02.2020, rreth orës 03:30, në Prishtinë, në parkingun e Hotel G... në rrugën "G.", për shkak të mosmarrëveshjeve të atëçastshme në mes të tani të dëmtuarit A.H. dhe të pandehurit I.B., me dashje që t'iu shkaktoj lëndime trupore të dëmtuarve A.H. dhe D.G., me armën- pistoletë e tipit "Walther", ngjyrë e zezë, e prodhimit gjerman, me numër serik BB95366 shtie në të dëmtuarin A.H. duke i shkaktuar plagë në regjionin e jashtëm të kërcirit të djathtë të këmbës së majtë, i cili sipas ekspertizës mjekoligjore cilësohet si lëndim i lehtë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

- me këto veprime, ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 të KPRK.

**2. S e p s e:** me datë, vend dhe kohë të njëjtë me dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, i akuzuari I.B. në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka pasur ne posedim armën - pistoletë e tipit Walther, ngjyrë e zezë, e prodhimit gjerman, me numër serik BB95366,-

- me këto veprime, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK, dhe

**3. S e p s e:** me ditë, kohë dhe vend si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, i akuzuari I.B., kur ka shtënë me armë, ka dëmtuar veturën e tipit “Hyunday Tucson”, ngjyrë e bardhë, me targa ..., e cila ishte e parkuar në parking, pronë e “L...”, e të cilën ka qenë duke e drejtuar M.L.,-

- me këto veprime, ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 17; 21; 38; 42; 69; 70; 79; 185 par. 2; 366, par. 1 dhe 321, par. 1 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP, të akuzuarit I.B. i shqipton:

- **Dënim burgimi, në kohëzgjatje prej dy (2) vite**, për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 të KPRK,
- **Dënim burgimi, në kohëzgjatje prej një (1) viti**, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK, dhe
- **Dënim burgimi, në kohëzgjatje prej tre (3) muaj**, për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK

Me aplikimin e nenit 76, par. 1 të KPRK dhe nenit 364 të KPP, të akuzuarit I.B., gjykata i shqipton:

### **DËNIM UNIK ME BURGIM**

- **Në kohëzgjatje prej tri (3) vite**, i cili do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën prerë;
- **Në dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit I.B., do të llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës 22.02.2020 deri me datë 12.06.2020, dhe nën masën e arrestit shtëpiak prej datës 12.06.2020 deri me datë 21.11.2020.**
  - Të dëmtuarit **A.(Xh.)H.**, nga Prishtina, lagjja L., rr. ”...” Hyrja-..., Kati ..., nr. ..., **D.(F)G.**, nga fshati B., rr. “...”, Komuna Prishtinë, **dhe pronari i “L...”**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil, pasi që, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm.
  - Të akuzuarit I.B. i konfiskohet arma - pistoleta e tipit “Walther”, ngjyrë e zezë, prodhim gjerman, me numër serik BB95366, e cila është përdorur për kryerjen e veprës penale. **Urdhërohet që sendi i sekuestruar – arma si më lart të shkatërrohet ose të kalojë në shfrytëzim nga Qeveria e Republikës së Kosovës.**

- Detyrohet i akuzuari I.B. që të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa dalin sipas regjistrimit të shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **njëqind (100) € dhe pesëdhjetë (50) € në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

## A R S Y E T I M I

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë/Njësia e Hetimeve të Përgjithshme me numër rasti 2020-AB-0416, të datës 22.02.2020, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/L.nr.44/2020, të datës 21.09.2020, për shkak të dyshimit të bazuar se i akuzuari I.B., ka kryer veprat penale Vrasje në tentativë, nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK; Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 të KPRK dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 321 të KPRK, ndërsa për të akuzuarit Rr.Z., për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 184, par. 1 të KPRK dhe B.F., i akuzuar për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 184, par. 1 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 01.10.2020, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari I.B. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pafajshëm për veprën penale Vrasje në tentativë Vrasje në tentativë, nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK, ndërsa ka pranuar fajësinë për veprat penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 të KPRK dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 321 të KPRK. Po ashtu, fajësinë e kanë pranuar edhe të akuzuarit Rr.Z., për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 184, par. 1 të KPRK dhe B.F., i akuzuar për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 184, par. 1 të KPRK.

Pasi që të akuzuarit Rr.Z. dhe B.F. kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar, kryetari i trupit gjykues pasi ka marrë mendimin e palëve në procedurë për veçimin e procedurës penale për të akuzuarit Z. dhe F., ka marrë aktvendim me të cilin ka veçuar procedurën penale për të akuzuarin I.B., për shkak të efikasitetit të përfundimit të procedurës penale ndaj të akuzuarve Z. e F., përkatësisht me qëllim të një gjykimi të drejtë dhe në një afat sa më të shkurtër të paraparë me dispozitat ligjore në fuqi dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.10.2020, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari I.B. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pafajshëm për veprën penale Vrasje në tentativë, nga neni 178, lidhur me nenin 28 të KPRK ndërsa për veprat penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 të KPRK dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 321 të KPRK, i akuzuari ka pranuar fajësinë.

Në fjalën e tij hyrëse, prokurori i shtetit ka deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe pasi të dëgjohen dëshmitë e të dëmtuarve - dëshmitarëve A.H. e D.G., po ashtu edhe dëshmitarët e propozuar në aktakuzë, gjithashtu dhe nga provat materiale që janë siguruar gjatë fazës së hetimit, siç janë raporti i Agjencisë së Kosovës së Forenzikë - Sektori për Balistikë, dhe ai i ADN-së, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore, CD-të me incizimet nga vendi i ngjarjes dhe raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes së bashku me fotografitë, nga të cilat do të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar si i pandehuri I.B., ka kryer veprat penale si në aktakuzë.

Ndërsa, në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka thënë se pas dëgjimit të dëshmisë së të dëmtuarve - dëshmitareve A.H. e D.G., nga dëshmitarët tjerë dhe provat materiale, siç janë raporti i AKF-sektori për balistikë dhe ai i ADN-së, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore, CD-të me incizimet nga vendi i ngjarjes, si dhe raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes së bashku me fotografitë, gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë janë plotësuar në tërësi elementet e veprave penale si në aktakuzë, përkatësisht në rastin konkret është fakt i pamohueshëm se i akuzuari ka pasur në pronësi armën në kundërshtim me ligjin për armët dhe me të njëjtën ka shtënë me qëllim të privimit nga jeta në drejtim të dëmtuarve, e ku ka arritur të godas të dëmtuarin A.H. por fatmirësisht jo me pasoja fatale për jetën duke mbetur në tentativë. Pastaj, prokurori i shtetit ka thënë se i dëmtuari-dëshmitari A.H. në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se data e saktë nuk i kujtohet, por ka qenë natë, kur ka qenë në punë si menaxher në diskotekën R..., e cila gjendet në katin e 13 të hotelit G..., e derisa diskoteka ka qenë duke u zbrazur për shkak të përfundimit të orarit të punës, ka dalë që ta përcjell shokun e tij D.G., i cili po shkonte në shtëpi dhe të cilin ishte duke e pritur Taxi, ndërsa gjatë rrugës për te Taxi para Hotel G..., papritmas nga prapa i është shfaqur tani i akuzuari I., pastaj është bërë një zhurmë, ka kthyer kokën prapa, aty ka parë të akuzuarin I. me allti (armë) në dorë duke shkuar në drejtim të tij larg njëri tjetrit rreth 1-1.5 metra, armën e kishte drejtuar drejt tij dhe ka shtënë dy herë në drejtim të tij, pastaj pas të shtënës së parë janë afruar shokët e tij- I., të cilët e kanë sulmuar dhe gjate asaj kohe I. ka shtënë për herë të dytë, arma ka qenë e drejtuar drejt gjoksit të tij, por plumbi e ka goditur në këmbë dhe e ka plagosur në këmbën e majtë, 20 centimetra mbi zogun e këmbës, pastaj i dëmtuari është rrëzuar në tokë dhe e kanë sulmuar prapë shokët e I., pastaj kanë intervenuar të pranishmit dhe pas disa sekondash apo minutash kanë ndërhyrë edhe policia. Po ashtu, prokurori i shtetit ka thënë se deri sa kanë qenë në diskotekë, I. i është ofruar afër tavolinës ku ka qenë ulur i dëmtuari A. dhe atij i ka thënë “o A. mafia shumë mangup ishe, të kallëzoi unë ty nesër”, duke menduar se ishte i dehur dhe nuk është marrë me të, e pas këtij bashkëbisedimi nuk është takuar më me I., duke shtuar se atë natë I. ka dalë rreth 40 minuta para meje nga diskoteka dhe të njëjtin e ka njohur si klient në diskotekë dhe nuk ka pasur ndonjë kontakt tjetër, përveç një rasti që ka ndodhur një keqkuptim kur tani i akuzuari I. ka bërë një rezervim për të dashurën e tij dhe pasi ajo ka ardhur me vonesë në lokal ka kërkuar me dëshirën e saj me ja ndërru tavolinën, e jo tavolinën që e kishte rezervuar I. por ka dashur një tavolinë tjetër, pasi që ajo është ulur aty ku ka dashur vet, tani i akuzuari I. përmes telefonit ia ka dërgu disa mesazhe me përmbajtje kërcënuese “ pse ia ke ndërru tavolinën, këtu paska djem afër dhe nuk jemi shok më, të kallëzoi unë ty”.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit D.G. e dhënë në prokurori me dt. 01.06.2020 dhe në polici me dt. 22.02.2020 e cila me pajtimin e palëve në procedurë është lexuar, e në të cilën ka thënë se I.B. nuk e ka njohur kurrë, duke shtuar se natën kritike ka qenë mysafir në disko 13, duke ndenjur me A.H. e disa shokë të tjerë dhe tri shoqe, e kur kanë dalë nga diskoteka, duke hipur në taksì ato shoqet, kanë ardhur disa persona dhe njëri nga ta ka qenë me revole dhe ka shtënë tri herë, ndërsa objekt i sulmit ka qenë A. por edhe ai pasi ka qenë afër, ka marrë disa goditje dhe ka qenë i rrezikuar nga ato të shtëna. Dëshmitari R.G., ka thënë se në muajin shkurt të vitit 2020 ka punuar punëtor sigurimi në diskotekën “...”, A.H. e ka njohur si menaxher të diskotekës, ndërsa I.B. nuk e ka njohur personalisht përveçse e ka parë në diskotekë dhe se nuk i kujtohet çfarë ka ndodhur atë natë sepse kanë kaluar gati katër vite, duke shtuar se krismë ka dëgjuar, por nuk e ka parë kush ka shtënë sepse ka qenë i ulur në kolltuk brenda hapësirave të hotelit “G...”, ndërsa krisma ka ndodhur jashtë hotelit “G...” dhe derisa ka dalë kanë ardhur policë civil.

Dëshmitari P.Sh. ka thënë se me datë 22.02.2020 ka punuar në diskotekën “...” si menaxher i sigurimit, se aty A.H. ka qenë menaxher në diskotekë, ndërsa të akuzuarin I.B. e ka njohur si myshteri e i cili gjithmonë ka qëndruar në zonën VIP, si myshteri i rregullt dhe nuk ka bërë probleme, duke shtuar se nuk ka parë e as dëgjuar se ka ndodhur diçka atë natë.

Dëshmitari G.Z., ka theksuar se me 22.02.2020 ka qenë duke punuar në diskotekën ... si sigurim, në hapësirën lart te VIP, se tani të dëmtuarin A.H. e njeh si koleg pune, ndërsa të akuzuarin I.B. nuk e njeh, dhe se atë natë nuk ka parë ndonjë parregullsi apo përlëshje, por nga kolegët e tij ka dëgjuar se poshtë, jashtë G... ka ndodhur një konflikt në mes tani të dëmtuarit dhe të akuzuarit, por unë nuk ka parë asgjë pasi ka qenë brenda.

Dëshmitari V.T., ka thënë se me datë 22.02.2020 ka punuar si sigurim në diskotekën ..., tek hyrja e objektit poshtë dhe në momentin kur ka ndodhur rasti ka qenë në diskotekë lart në katin e ..., duke shtuar se të akuzuarin e ka njohur vetëm si klient, i njëjti i ka respektuar dhe nuk kanë pasur asgjë të keqe me të dhe se ka ndodhur një përlëshje, ka kuptuar pas përlëshjes.

Dëshmitari M.L., ka deklaruar se në parkingun e hotelit G... në Prishtinë ka punuar dhe punon akoma, duke shtuar se nuk i kujtohet data 22.02.2020, por përafërsisht në atë kohë i kujtohet se ka dëgjuar të shtëna, ka qenë zhurmë por nuk ka parë asgjë sepse në atë kohë nga diskoteka ka dalë një grumbull i madh i njerëzve dhe kur ka dëgjuar një krismë ka qenë brenda në kabinë, pastaj ka dalë nga kabina dhe ka ecur në drejtim të hyrjes së hotelit G..., e kur ka arritur te hyrja është takuar me pjesëtarët e tjerë të sigurimit dhe menjëherë ka ardhur policia, e të cilët i ka parë duke prangosur disa persona të panjohur për të, por se nuk ka parë as përlëshje e as të shtëna drejtpërdrejt, pasi ka qenë në kabinë dhe ka qenë në telefon, por krisma ia ka tërhequr vëmendjen, e ka mbyllur telefonin dhe ka dalë.

I pandehuri I.B. ka deklaruar se natën kur ka ndodhur rasti qëllimi i tij nuk ka qenë që ta vras A.H., pasi ngjarja ka ndodhur rastësisht dhe ai do ta kishte bërë atë gabim po të mos kish qenë në burg më parë por e di se çka është burgu dhe nuk e bën atë sepse po ta vrasësh dikë e ke vrarë vetën, sepse në liri mund të mos e durosh një person por në burg ke për t'i duruar 500, duke shtuar se tani të dëmtuarin A. e ka pasur shok, i ka dërguar njerëz më shumë se 100 herë për tu pajtuar, por ai nuk ka pranuar, duke shtuar se të njëjtin e ka takuar në qytet e në Brezovicë, por nuk kanë pasur diçka të keqe dhe nuk ka tentuar t'i bëjë asgjë, duke theksuar se ka dalë nga vetura dhe ka shkuar të flas me A., pasi lart kishin pasur një problem, ndërsa A. e ka provokuar dy herë dhe kur i është afruar rreth dy metra afër tij, A. e ka nxjerr thikën ndërsa ai ka nxjerrë armën dhe ka shtënë teposhtë për ta frikësuar dhe e shtëna e ka gërvishtur në këmbën e majtë, e në ato momente ka ardhur policia dhe e ka arrestuar.

Po ashtu, prokurori i shtetit ka thënë se vërtetimi i gjendjes faktike është bërë edhe nga: Rezultatet e ekzaminimit të ADN-së- raporti i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. AKF/2020-0678/2020-604, e datës 08.06.2020, nga e cila rezulton se është një person i gjinisë mashkullore i panjohur por për shkak të problemeve teknike të AKF nuk është arritur të bëhet krahasimi me bazën e të dhënave dhe nuk ka ndonjë rezultat nga kjo provë; Raporti i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë - sektori për balistikë me AKF/2020-0678/2020-605, e datës 11.03.2020; Mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore dr. N.U., i datës 04.06.2020, me të cilin është vërtetuar se dëmtimet që i ka marrë i dëmtuari A.H. janë shkaktuar nga arma e zjarrit dhe si rezultat dinamik i predhës së hedhur nga arma ë zjarrit, kurse një pjesë të dëmtimeve e ka me lëndime të lehta trupore më pasoja të përkohshme për shëndetin, si rezultat i veprimit mjetit mekanik jo të fortë mprehtës, ndërsa kur shikojmë video incizimin kur është shkaktuar vepra penale nga tani i akuzuari ndaj të dëmtuarve A.H. e D.G., edhe pse për D.G. nuk kemi mendim të ekspertit mjeku ligjor për ndonjë lëndim, pasi i njëjti nuk është vizituar te mjeku pasi ka qenë më shumë i shqetësuar për A.; CD-të e shikuara në shqyrtim gjyqësor, në të cilën paraqiten mesazhet e të akuzuarit I. drejtuar të dëmtuarit A.H. para se të ndodh ngjarja, me përmbajtje se nuk ia ka siguruar tavolinën e duhur lidhje me femrën e tij, edhe pse i njëjti i thotë “i kam rehatuar ku kanë dashtë” pastaj i thotë prapë “qe po këqyri”, I. i ka shënuar “ku aty, paska huta...” pastaj A. i shkruan “pasha zotin ku kanë dashtë aty janë ulur, s’po di” pastaj A. i thotë “kadal bre se po shkoj po kqyri, kadal vllai jem se unë nuk i uli njerëzit se kam dashtë me t’ba nder, se as rezervime nuk boj qitash shkon djali kqyr çka mujna me bo, je kam thu pa faj po nejtse ti e din”, pastaj I. i thotë “ok zatetemi”; Nga shikimi i CD nga kamera e sigurisë te rampa, në pamje

paraqitet A. dhe D. në dalje të G... dhe tri shoqet e tyre, prapa tyre shihet vetura Golf, i zi, horizontalisht, në të cilin ka qenë i akuzuari I., e cila shkon pak prapa pastaj nga ajo del I., pas tij dalin Rr. dhe B.- shokët e I., të cilët vrapojnë pas I., nga ana tjetër shihen dritat e krismave dhe njerëz të cilët deri sa shikonin për një çast ikin, pastaj vërehet një përleshje në të cilën nga të akuzuarit sulmohen A. dhe D., pastaj vërehen njerëz duke i ndarë, e pasi i kanë ndarë vërehet i akuzuari I. duke shkuar drejt tani të dëmtuarit A. me revole në dorë dhe shtie drejt A., i cili largohet drejt ndërsa tani të akuzuarit ikin në drejtimin e kundërt, pastaj i dëmtuari A. vërehet duke e njoftuar policinë dhe po ashtu vrapon pas tyre. Në fund të fjalës së tij përfundimtare, prokurori i shtetit ka thënë se në asnjë mënyrë nuk ka vend për ndonjë rrethanë që përjashton ekzistimin e veprës penale, nga të gjitha provat e administruara nuk është dëshmuar se i akuzuari I.B. ka qenë i rrezikuar nga A.H. apo D.G., ndërsa rrethanë lehtësuese në këtë rast konkret të merret mosha e re e I.B., duke shpresuar se është vetëdijesuar dhe se mund të jetë pjesëtar i dobishëm për shoqërinë në të ardhmen e nuk do të përsëris më vepra penale, pasi që nga provat e cekura me lart është vërtetuar në tërësi përtej dyshimit mirë të bazuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, duke kërkuar nga gjykata që pasi t'i vlerësoj rrethanat rënduese dhe lehtësuese të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas kodit.

Në fjalën hyrëse përfaqësuesja e palës së dëmtuar A.H., av. Merita Stublla- Emini ka thënë se e përkrah fjalën e prokurorit të shtetit dhe është e bindur se gjatë procedurës gjyqësore do të vërtetohet pakontestueshëm se veprën penale e ka kryer i pandehuri Q., e po ashtu, provat materiale të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës e vërtetojnë se vepra penale i ka të gjitha elementet e figurës të së njëjtës dhe se deklaratimet e palëve në procedurë, përkatësisht të dëmtuarit z. H., pakontestueshëm do të bindin të gjithë për fajësinë e të pandehurit.

Ndërsa, në fjalën e tij përfundimtare përfaqësuesja e palës së dëmtuar ka thënë se baza juridike e aktakuzës është e fortë, e mbështetur në prova të pakontestueshme, se ka pasur dashje për të dëmtuar dhe lënduar fort të dëmtuarin A.H., i cili i ka shpëtuar vdekjes vetëm si mrekulli dhe se rreziku për jetën, dhimbjet, frika, etj; kanë lënë vrugë të përjetshme te i dëmtuari, duke theksuar se pa asnjë mëdyshje është vërtetuar se në kohën dhe vendin e paraqitur në aktakuzë, ka ndodhur ngjarja e cila është objekt i shqyrtimit, e për të cilën të akuzuarit Rr.Z. e B.F. kanë pranuar fajësinë. Pastaj përfaqësuesja ka thënë se nga raportet e ekspertizave, video incizimet, dëshmitë e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve është vërtetuar pa asnjë mëdyshje se vepra penale është kryer, duke shtuar se tani i dëmtuari nuk ka pasur “as hak e as hile” në këtë çështje por ka qenë cak për qitje me qëllim të privimit nga jeta të tani të dëmtuarit, ka shtënë me armë zjarri drejt tij, duke shtuar se beson dhe shpreson që drejtësia do të vihet në vend andaj ka propozuar që të akuzuarin gjykata ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari A.H., në fjalën e tij përfundimtare ka thënë se e përkrah fjalën e përfaqësueses së tij dhe pret që i akuzuari të shpallet fajtorë, të marrë dënimin e merituar, si dhe paraqet kërkesë pasurore juridike, vlerën e së cilës tani për tani nuk e di.

Mbrojtësja e të akuzuarit I.B., av. Lendita Keqekolla - Gashi, në fjalën hyrëse ka deklaruar se i mbrojturi i saj ka pranuar dy veprat penale përveç asaj të pikës I të dispozitivit të aktakuzës, për të cilën nuk ka asnjë provë materiale që vërteton apo arsyeton këtë pikë të aktakuzës nga ana e prokurorisë, duke shtuar se gjatë mbrojtjes do të dëshmohet pafajësia e të mbrojturit të saj, pasi po të kishte ekzistuar dashja, i mbrojturi i saj në ditën kritike në vendin e ngjarjes me të dëmtuarin kishte afërsi më pak se dy metra dhe goditjet kanë qenë vetëm për ta frikësuar pa dashur ta godet në pjesët vitale apo për ta privuar nga jeta tani të dëmtuarin A., pasi që i mbrojturi i saj që nga koha që ka ndodhur rasti asnjëherë nuk ka pasur asnjë telashe qoftë edhe verbale me tani të dëmtuarin A., i njëjti është penduar thellë

dhe ndihet i turpëruar në veçanti para familjarëve të të dëmtuarit A., ku deri më tani nuk ka kursyer që t'i dërgoj persona për t'i sanuar raportet e tij me tani të dëmtuarin, por i dëmtuari këtë ia ka lënë gjykatës.

Ndërsa, në fjalën e saj përfundimtare, mbrojtësja e të akuzuarit ka theksuar se nuk ka prova materiale që e vërtetojnë apo arsyetojnë veprën penale të vrasjes në tentativë, pasi që po të kishte ekzistuar dashja sipas pretendimeve të prokurorisë, i mbrojturi i saj ditën kritike në vendin e ngjarjes, me tani të dëmtuarin kishte afërsi më pak se dy metra dhe të shtënat kanë qenë vetëm për ta frikësuar, pa dashur të godas të dëmtuarin në pjesët vitale apo të njëjtin ta privoj nga jeta. Pastaj, mbrojtësja e të akuzuarit ka thënë se prokuroria nuk e ka arsyetuar dashjen direkte dhe qëllimin e kryesit, të cilat janë elementet qenësore të veprës penale, duke shtuar se kualifikimi i prokurorisë nuk mbështetet nga deklaratat e dëshmitarëve dhe CD-të me pamjet e ngjarjes ku shihet i mbrojturi i saj dhe palët e dëmtuara në një distancë mjaft të afërt, e sikur i mbrojturi i saj të kishte qëllim dhe dashje për t'i privuar nga jeta të dëmtuarit, shumë lehtë do ta bënte këtë, duke theksuar se bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor për tani të dëmtuarin A.H., i njëjti ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, andaj i ka propozuar gjykatës që të bëjë rikualifikimin e veprës penale nga vrasje në tentativë në lëndim i lehtë trupor, duke marrë parasysh edhe faktin se nga kjo ngjarje e deri tani, i mbrojturi i saj dhe i dëmtuari H. nuk kanë pasur ndonjë incident dhe i ka premtuar gjykatës se edhe në të ardhmen do të ketë kujdes të shtuar.

I akuzuari I.B., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij, duke shtuar se i ka dërguar njerëz të dëmtuarit A. për tu pajtuar, derisa gjatë gjykimit i kishte kërkuar 100 herë falje të dëmtuarit dhe se ishte penduar për rastin, por tanimë rasti ka ndodhur. Pastaj, i akuzuari ka theksuar se nuk kishte pasur qëllim ta vras të dëmtuarin sepse po të kishte pasur atë qëllim do ta kishte vrarë veten sepse e dinte se çka është burgu, duke shtuar se atë gabim mund ta bënte vetëm dikush që nuk ka qenë në burg kurrë, duke i premtuar gjykatës se nuk do të ndodhë më kjo dhe nuk do të vijë në këtë pozitë ku ndodhet tani. Po ashtu, i akuzuari ka thënë se është mbajtës i familjes, jeton me motrën dhe nënën, e cila është e sëmurë dhe ka dëshirë që sa të jetë gjallë ajo t'i qëndroj afër. Në fund të fjalës së tij, i akuzuari përsëri i ka kërkuar falje palës së dëmtuar, duke shprehur keqardhje me falët "por kishte ndodhur dhe nuk ç bëhej më".

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë dëgjuar dëshmitarët R.G.; P.Sh.; G.Z.; V.T. dhe M.L., dhe është lexuar dëshmia e të dëmtuarit D.G. janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria e mbrojtësi si dhe nga mbrojtja e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, e të paraqitura si në vijim:

Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit A.H., i cili pasi është njoftuar me të drejtat e dëshmitarit, nën betim ka deklaruar se data e saktë nuk i kujtohej, por ishte natë, kur ishte në punë si menaxher në diskotekën R..., e cila gjendej në katin e ... të hotelit G..., e derisa diskoteka ishte duke u zbrazur për shkak të përfundimit të orarit të punës, kishte dalë që ta përcjell shokun e tij D.G., i cili po shkonte në shtëpi dhe të cilin ishte duke e pritur Taxi, ndërsa gjatë rrugës për te Taxi para Hotel G..., papritmas nga prapa ishte shfaqur tani i akuzuari I., pastaj ishte bërë një zhurmë, kur e kishte kthyer kokën prapa, aty kishte parë të akuzuarin I. me allti (armë) në dorë duke shkuar në drejtim të tij larg njëri tjetrit rreth 1-1.5 metra, armën e kishte drejtuar drejt tij dhe kishte shtënë dy herë në drejtim të tij, pastaj pas të shtënës së parë ishin afruar shokët e tij-I., të cilët e kishin sulmuar dhe gjatë asaj kohe I. kishte shtënë për herë të dytë ku edhe e kishte plagosur, pastaj i dëmtuari ishte rrëzuar në tokë ku e kishin sulmuar prapë shokët e I., derisa kishin intervenuar të pranishmit e pas disa sekondash apo minutash kishin ndërhyrë edhe policia. Po ashtu, i dëmtuari A.H. ka thënë se deri sa ishin në diskotekë, I. i ishte ofruar afër tavolinës ku

ishte ulur i dëmtuari A. dhe atij i kishte thënë “o A. mafia shumë mangup ishe, të kallëzoi unë ty nesër”, e duke menduar se ishte i dehur nuk është marrë me të, e pas atij bashkëbisedimi nuk është takuar më me I. përveç ngjarjes duke shtuar se I. kishte dalë nga diskoteka rreth 40 minuta para tij, duke theksuar se tani të akuzuarin I. e kishte njohur si klient në diskotekë dhe nuk kishte pasur ndonjë kontakt tjetër asnjëherë përveç një rasti që kishte ndodhur një keqkuptim kur tani i akuzuari I. kishte bërë një rezervim për të dashurën e tij dhe pasi ajo ka shkuar me vonesë në lokal ka kërkuar me dëshirën e saj me ja ndrru tavolinën, e jo tavolinën që e kishte rezervuar I. por ka dashur një tavolinë tjetër, pasi që ajo ishte ulur aty ku kishte dashur vet, tani i akuzuari I. përmes telefonit ia kishte dërguar disa mesazhe me përmbajtje kërcënuese “pse ia ke ndërru tavolinën, këtu paska djem afër dhe nuk jemi shok më” dhe mesa mban mend edhe fjalët “të kallëzoi unë ty”, derisa gjatë zbritjes nga diskoteka lifti ishte plot, ai kishte qenë me D. dhe kishte pasur edhe vajza të cilat ishin kliente, me njërin nga të cilat ka pasur një lidhje. Pastaj, i dëmtuari H. ka thënë se është i plagosur në këmbën e majtë, 20 centimetra mbi zogun e këmbës dhe se tani nuk i kujtohej situata që arma ka qenë e drejtuar drejt gjoksit të tij, por plumbi e kishte goditur në këmbë, duke theksuar se kishte ndërhyrë dikush por nuk e njihte, por i njëjti shihej në video-incizimet, duke shtuar se si rezultat i ndërhyrjes së personit tjetër, nga e shtëna e I. it plumbi e kishte goditur në këmbë, por se I. ishte duke shkuar në drejtim të tij me armë të drejtuar në gjoksin e tij, e gjatë asaj kohe kishte edhe përleshje në mes të shokëve të I. në njërin anë dhe atij-A. e D. në anën tjetër, ndërsa një person i ka kërcyer në armë I., përkatësisht ia ka lëvizur dorën dhe arma ka shtënë, por nuk e din nëse nga kjo e shtënë ishte plagosur, përkatësisht nuk e dinte saktë se nga cila e shtënë ishte plagosur, por mendon që ishte lënduar nga plumbi i dytë dhe nuk e mban mend në çfarë pozicioni ishte në atë moment, por kishte qenë në mes të plumbave. Po ashtu, i dëmtuari H. ka thënë se nga e shtëna e parë në të dytën kishin kaluar disa sekonda dhe rreth një orë pas ngjarjes kishte shkuar te mjeku pasi që në fillim kishte qenë në polici, e aty e kishte marrë ambulanca dhe ishte trajtuar te mjeku rreth 2-3 orë, pastaj e kishin liruar dhe e kishte vazhduar mjekimin në shtëpi, derisa nuk kishte dalë në punë pasi nuk kishte mundur të shkelë me këmbën e majtë, por kishte lëvizur me ndihmën e të tjerëve, duke theksuar se atë natë i kishte parë dy të shtëna, por i kishte dëgjuar tri të shtëna, e të shtënën e parë e kishte dëgjuar nga prapa, të shtënën e dytë e kishte parë derisa ishte duke u përleshur apo i rrëzuar dhe me sa mban mend të shtënën e tretë e kishte dëgjuar duke shtuar se armën e kishte parë por nuk e dinte se nga ka shkuar plumbi dhe e kishte vërejtur se ishte i plagosur gjatë kohës sa ishte në polici. Pastaj, i dëmtuari H. ka theksuar se as atë ditë e asnjëherë nuk mban me vete armë apo mjete për vetëmbrojtje, duke shtuar se përderisa tani i akuzuari ia kishte drejtuar armën në gjoks mendon se ai ka dashur ta vras, duke shtuar se punëtori që i është gjuajtur në armë I. ishte punëtor i sigurimit, por nuk është i sigurt cili ishte, dhe se me I. pas kësaj ngjarje nuk kishte pasur asnjë problem, por ndihet i rrezikuar dhe për këtë kishte kërkuar ndihmë nga prokurori, për faktin se i akuzuari atëherë kishte qenë në liri dhe ishte ndjerë i kërcënuar edhe pse nuk kishte pasur asgjë të keqe me të por ai kishte tentuar ta vras, derisa pas ngjarjes, i akuzuari I. kishte dërguar njerëz për t’u pajtuar, por nuk e kishte treguar arsyen për veprimet e tij - pse e ka bërë duke theksuar se i akuzuari ka pasur pengesë të shtinte me armë prapë në drejtim të tij sepse policia kishte ardhur shpejtë - brenda disa sekondash dhe se asnjëherë tani i akuzuari I. nuk ka pasur ndonjë të keqe nga ai – A., e cila do ta shtynte atë që të hakmerrej ndaj tij.

Leximi i dëshmisë së të dëmtuarit - dëshmitarit D.G. e dhënë në prokurori me datë 01.06.2020 dhe në polici me datë 22.02.2020, ku ka theksuar se qëndron pranë deklaratës së datës 22.02.2020 të dhënë në polici, duke shtuar se I.B. nuk e ka njohur e as parë kurrë, duke shtuar se natën kritike ka qenë mysafir në diskotekën ..., e aty kishte ndenjur me tani të dëmtuarin A. dhe disa shokë të tjerë e tri shoqe, pastaj kur kishin dalë nga ndeja kishin dalë për t’i përcjell ato shoqet të cilat duke hipur në taksì kanë ardhur disa persona dhe njëri nga ta ishte me revole dhe kishte shtënë tri herë, e të shtënat i kishte dëgjuar dhe objekt i sulmit ishte A.H., por edhe



ai - D. që ishte afër kishte marrë disa goditje, e po ashtu ishte rrezikuar nga ato të shtëna sepse ishte shumë afër me A. dhe ka mundur të pësoi nga arma. Pastaj, i dëmtuari D.G. ka theksuar se ai kishte ardhur në pushim nga Islanda dhe ishte e papritur ajo që ka ndodhur, si dhe nuk e di arsyen pse ka ndodhur, duke shtuar se me datë 22.02.2020 në ora 03:30 derisa kanë qenë duke i përcjell tri vajzat, bashkë me A. që ishte menaxher kryesor i diskotekës, i kishte shkuar një djalë nga prapa, kishte nxjerrë revolen dhe kishte filluar të shtie në drejtim të A., e më pas kishin ardhur edhe dy - tre shokë të tij dhe kishin filluar t'i sulmonin fizikisht, me ç rast e kishin goditur disa here prapa shpine, ndërsa personi me armë nuk ndalonte të shtënat, e në atë moment kishte shkuar sigurimi por situata nuk ishte qetësuar derisa në vendngjarje kishte shkuar policia, dhe se personin që kishte shtënë nuk e kishte parë asnjëherë dhe nuk e dinte se kush është ndërsa A. e kishte shok.

Dëshmia e dëshmitarit R.G., i cili pasi është njoftuar me të drejtat e tij, nën betim ka deklaruar se në muajin shkurt të vitit 2020 kishte punuar si punëtor sigurimi në diskotekën "...", e aty A.H. e kishte njohur si menaxher të diskotekës ndërsa I.B. nuk e kishte njohur personalisht përveçse e kishte parë në diskotekë, duke shtuar se nuk i kujtohet çfarë ka ndodhur atë natë sepse kanë kaluar gati katër vite, por detyra e tij si punëtor sigurimi ka qenë t'i kontrolloj njerëzit te zona VIP (pjesë e veçantë e lokalit me rezervime) e cila gjendet në katin e ... Pastaj, dëshmitari R.G. ka thënë se kishte ndodhur që A.H. ta ketë njoftuar për ndonjë problem, sepse probleme kishin pasur shpesh, 5-6 raste brenda natës si tip fërkimesh mes klientëve, ndërsa ata - punëtorët e sigurimit është dashur të ndërhyjnë për t'i ndarë, duke shtuar se ka mundësi që A. ta ketë njoftuar por tani nuk i kujtohej, përveçse natën kur kishte ndodhur ngjarja ai kishte dëgjuar një krismë jashtë objektit, derisa ai ka qenë i ulur në kolltuk brenda hapësirave të hotelit "G..." në kohën kur diskoteka ishte duke u mbyllur dhe klientët kishin filluar të dilnin.

Dëshmia e dëshmitarit P.Sh., i cili pasi është njoftuar me të drejtat e dëshmitarit, nën betim ka deklaruar se me datë 22.02.2020 ka punuar si menaxher i sigurimit në diskotekën "...", e cila gjendet në objektin e hotelit "G..." në katin e ... dhe se A.H. e ka njohur si menaxher të kësaj diskoteke, ndërsa të akuzuarin I.B. e kishte njohur si myshteri, duke shtuar se gjatë kohës sa ka punuar në këtë diskotekë, A. nuk ka pasur probleme me dikë dhe se tani i akuzuari I.B. gjithmonë kishte qëndruar në zonën VIP, si klient i rregullt dhe nuk kishte bërë probleme. Po ashtu, dëshmitari P.Sh. ka thënë se diskoteka zakonisht ka filluar punën në ora 23:00 dhe ka punuar deri në orët 03:00-04:00 të mëngjesit, duke shtuar se natën kur ka ndodhur rasti mund të ketë qenë në punë deri në ora 04:00 të mëngjesit, por nuk kishte parë e as dëgjuar se kishte ndodhur diçka atë natë, derisa për këtë kishte kuptuar të nesërmen nga pronari i diskotekës i cili i kishte njoftuar për ngjarjen të gjithë stafin, e atyre iu kishte thënë se A.H. e ka pasur një incident dhe asgjë më tepër.

Dëshmia e dëshmitarit G.Z., i cili pasi është njoftuar me të drejtat e dëshmitarit, nën betim ka deklaruar se me datë 22.02.2020 ka punuar si sigurim në hapësirën VIP në diskotekën ..., duke shtuar se tani të dëmtuarin A.H. e njeh si koleg pune, ndërsa të akuzuarin I.B. nuk e njeh dhe nuk kishte pasur kontakt me të asnjëherë, duke theksuar se natën kritike, aty ku ishte duke punuar nuk kishte parë ndonjë parregullsi apo përlëshje, por nga kolegët e tij kishte dëgjuar se poshtë, jashtë G... kishte ndodhur një konflikt në mes të dëmtuarit dhe të akuzuarit, por ai nuk ka parë asgjë pasi që ka qenë brenda.

Dëshmia e dëshmitarit V.T., i cili pasi është njoftuar me të drejtat e dëshmitarit, nën betim ka deklaruar se me datë 22.02.2020 ka punuar si sigurim te hyrja e objektit poshtë në diskotekën ... dhe në momentin kur ka ndodhur rasti ai ka qenë në diskotekë lart në katin e ..., duke shtuar se A.H. e njeh pasi i njëjti ka qenë si aksionar në diskotekën ..., ndërsa të akuzuarin e kishte

njohur vetëm si klient, i cili i kishte respektuar dhe nuk kishin pasur asgjë të keqe me të, përkatësisht nuk ishte sjell keq me ta – punëtorët e diskotekës. Ndërsa, se ka ndodhur një përlëshje e kishte kuptuar pas përlëshjes, pasi që ai nuk ishte në vendin e ngjarjes dhe nuk i dinte arsyet e përlëshjes dhe mesa kishte njohuri i dëmtuari A.H. nuk kishte pasur ndonjë problem me klientët në diskotekë dhe se ishte hera e parë që ka dëgjuar se A. i kishte ndodhur ky rast dhe kishte shprehur keqardhje, duke theksuar se nuk e dinte arsyen e zënkës në mes të akuzuarit I.B. dhe të dëmtuarit A.H.. Pastaj, dëshmitari V.T. ka thënë se klientët që shkojnë në diskotekë i kontrollojnë dhe nëse kanë armë kthehen ose i dërgojnë në veturat e tyre duke shtuar se natën kritike I.B. e kishte parë në diskotekë por nuk e dinte çfarë hanë dhe pinë klientët sepse ai nuk kishte qenë i caktuar të hyrja dhe derisa ai kishte qenë lart në diskotekë pasi kishte shkuar të marr pije dhe kishte shfrytëzuar tualetin, deri sa ishte kthyer poshtë ngjarja veçse kishte ndodhur dhe asnjëherë nuk kishte vërejtur që A.H. dhe i akuzuari I. të kenë pasur ndonjë mosmarrëveshje.

Dëshmia e dëshmitarit M.L., i cili pasi është njoftuar me të drejtat e dëshmitarit, nën betim ka deklaruar se në parkingun e hotelit G... në Prishtinë ka punuar dhe punon akoma, por se nuk i kujtohet data 22.02.2020, por përafërsisht në atë kohë i kujtohet se kishte dëgjuar të shtëna, pasi në atë kohë nga diskoteka kishte dalë një grumbull i madh i njerëzve dhe kur kishte dëgjuar një krismë kishte qenë brenda në kabinë, pastaj kishte dalë nga kabina dhe kishte ecur në drejtim të hyrjes se Hotelit G..., e kur kishte arritur te hyrja ishte takuar me pjesëtarët e tjerë të sigurimit dhe menjëherë kishin ardhur policia, të cilët i kishte parë duke prangosur disa persona për të të panjohur, duke përsëritur se nuk kishte parë as përlëshje e as të shtëna drejtpërdrejt, pasi gjendej në kabinë dhe kishte qenë në telefon, ndërsa krisma ia kishte tërhequr vëmendjen, pastaj e kishte mbyllur telefonin dhe kishte dalë, e deri sa ishte duke ecur drejt hyrjes së Hotel G... e kishte dëgjuar edhe një krismë por nga ishte shtënë nuk e dinte dhe nuk kishte parë përlëshje, ndërsa policia kishte ardhur menjëherë duke theksuar se tani të akuzuarin në sallë nuk e njeh por personin me emrin A.H. e njihte vetëm si menaxher i diskotekës ... dhe se asnjëherë nuk kishte dëgjuar nëse A.H. ka pasur ndonjë problem gjatë punës në diskotekë.

- **CD**, në të cilën paraqiten mesazhet në të cilat i akuzuari I. i drejtohet të dëmtuarit A.H. para se të ndodh ngjarja me përmbajtje se nuk ia ka siguruar tavolinën e duhur në lidhje me femrën e tij edhe pse i njëjti i thotë “ i kam rehatuar ku kanë dashtë” pastaj i thotë prapë “qe po këqyri”, pastaj I. i ka shënuar “ku, aty paska huta...” pastaj A. i shkruan “pasha zotin ku kanë dashtë aty janë ulë, s’po di” pastaj A. i thotë “kadal bre se po shkoj po këqyri, kadal vëllai jem se unë nuk i uli njerëzit se kam dashtë me t’ba nderë, se as rezervime nuk bëj qitash shkon djali këqyr çka mujna me bo, je kam thu pa faj po nejse ti e di”, pastaj I. i thotë “ok zatetemi”;

- Rezultatet e ekzaminimit të ADN-së nga Raporti i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/2020-0678/2020-604, i datës 08.06.2020, nga i cili rezulton se është një person i gjinisë mashkullore i panjohur por për shkak të problemeve teknike të AKF nuk është arritur të bëhet krahasimi me bazën e të dhënave dhe nuk ka ndonjë rezultat nga kjo provë;

- Raporti i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë- sektori për balistikë AKF/2020-0678/2020-605, i datës 11.03.2020, ky raport tregon llojin e armës së përdorur e cila ka qenë funksionale dhe se gëzhojat e gjetura në vend të ngjarjes janë shkrepur nga kjo pistoletë – PHAG VALTER, ngjyrë e zezë më numër serik BB95366; dhe

- Mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. N.U., i datës 04.06.2020, sipas të cilit është vërtetuar se dëmtimet që i ka marrë i dëmtuari A.H. janë shkaktuar nga arma e zjarrit dhe si rezultat dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit, ndërsa një pjesë të dëmtimeve e ka me lëndime të lehta trupore më pasoja të përkohshme për shëndetin, si rezultat i veprimtimit të mjetit mekanik jo të fortë mprehtës, e kur këto prova të nxjerra nga profesionistët e

fushave përkatëse e përmbushin pamjen e parë nga video incizimi kur është shkaktuar vepra penale nga tani i akuzuari ndaj të dëmtuarve A.H. e D.G., edhe pse për D.G. nuk ka mendim të ekspertit mjeko ligjor për ndonjë lëndim, pasi i njëjti nuk është vizituar te mjeku sepse ka qenë më shumë i shqetësuar për A.

Pas konsultimit me mbrojtësin e tij, i akuzuari I.B. ka deklaruar se do ta shfrytëzoi të drejtën e tij për tu përgjigjur dhe në pyetje nga mbrojtësja e tij ka deklaruar se natën kur ka ndodhur rasti qëllimi i tij nuk ka qenë që ta vras A.H. dhe se ngjarja ka ndodhur rastësisht, duke shtuar se ai do ta bënte atë gabim sikur të mos kishte qenë në burg më parë por e dinte se çka ishte burgu dhe nuk e bën atë sepse po ta vrasësh dikë e ke vrasë vetën, sepse në liri mund të mos e durosh një person por në burg ke për t'i duruar 500, duke theksuar se tani të dëmtuarin A. e kishte pasur shok, e të cilit një javë para këtij rasti më 14.02.2020 për ditëlindje ia kishte dërguar një shishe shampanjë dhe me të kishin ndenjur në diskotekë, por kafe nuk kishin pirë së bashku, derisa pas kësaj ngjarje, A.H. i kishte dërguar njerëz më shumë se 100 herë, për tu pajtuar, por ai gjithnjë ka refuzuar. Po ashtu, i akuzuari I.B. ka deklaruar se tani të dëmtuarin A. e kishte takuar në qytet, në Brezovicë, por nuk kishin pasur diçka të keqe dhe nuk ka tentuar t'i bëjë asgjë, e për këtë që ka ndodhur ka thënë se është penduar por kjo ka ndodhur dhe nuk ç'bëhet. Në pyetje nga prokurori i shtetit, i akuzuari ka deklaruar se para ngjarjes vetura e tyre ishte e parkuar dhe kishin qenë duke u larguar nga parkingu i Hotelit G..., e aty nuk kishin qëndruar 40 minuta siç pretendon A., i cili në atë kohë nuk kishte dalë asnjëherë jashtë sepse daja i tij D.S. ka qenë pronar, ndërsa A. ka qenë menaxher kryesor dhe lart në diskotekë i kishin ndërruar disa fjalë me A., pastaj në ora 03:30 kishte përfunduar punën diskoteka dhe ata kishin dalë, por nuk i ka shkuar mendja se A. do të dilte nga diskoteka, por ai kishte dalë me dy femra, ndërsa shoku i tij Rr. i kishte thënë "këqyre ku dulë A. dhe po na këqyr", pastaj ai - I. e kishte kthyer kokën e kishte parë A. duke i dërguar ato vajzat në taksi së bashku me disa shokë të tij, pastaj kishte dalë nga vetura dhe kishte shkuar të flas me A., pasi lart kishin një problem, pasi atje A. e kishte provokuar dy herë dhe dëshironte të fliste me të, përkatësisht ta pyeste se pse po e provokonte, mirëpo kur i ishte afruar rreth dy metra afër tij, A. e kishte nxjerrë thikën ndërsa ai - I. e kishte nxjerrë armën dhe kishte shtënë përpjetë, pastaj menjëherë e kishin kapur punëtorët e sigurimit për krahu ( H.G. dhe një tjetër), e kur shokët e tij e kishin parë ngjarjen, kishin dalë nga kerri, kishin ardhë dhe ishin ballafaquar me A., pastaj kanë filluar të rrahen, ndërsa ai-I. ka qenë pak më anash 2-3 metra, e kur i kishte parë shokët duke u therrë kishte menduar se po i mbytë, pastaj ishte nisur në drejtim të A. dhe kishte shtënë me revole teposhtë për ta frikësuar, e kjo e shtënë e ka gërvishtur në këmbën e majtë, pastaj në ato momente ka ardhur policia, pastaj ai ishte shtrirë, policia e kishte arrestuar dhe nuk kishte pasur asnjë qëllim të gjuaj nga prapa sepse po të kishte dashur do të kishte shtënë nga vetura dhe do të kishte ikur. Pastaj, i akuzuari Q. ka thënë "nëse del se në pamjet që i pamë më herët, A. nuk ka thikë mua lirisht jepmini 10 vite burgim dhe menjëherë shkoj në mbajtje të dënimit edhe pse nënën e kam në gjendje të rëndë shëndetësore". Në pyetje nga përfaqësuesja e të dëmtuarit A.H., i akuzuari Q. është përgjigjur se ai e kishte ditur se A. nuk ka dalë asnjëherë më herët nga diskoteka sepse e kishte shok dhe me të kishte biseduar 100 herë, pasi që kur kishte shkuar ndonjë shok i tij në diskotekë, ai - I. i kishte thënë A. me sms ose gojarisht "a po del me marrë një shok timin poshtë" por ai gjithmonë i kishte thënë "nuk muj me dalë poshtë deri sa ta kryej barazimin, me kamarierë me sigurima" sepse ata i ka paguar çdo ditë dhe A. ka qenë kryesori, duke theksuar se armën e kishte me vete kur ka shkuar të bisedoj me A. dhe se të njëjtin nuk ka qenë duke e prituri pasi nuk e kishte ditur kur del nga diskoteka dhe po të kishte pasur qëllimin që ta vras do ta kishte prituri nga ora 5 e 30 kur ai dilte nga diskoteka.

Në pyetje te kryetarit të trupit gjykues, i akuzuari Q. është përgjigjur se para se të ndodhte ngjarja ai ishte brenda në diskotekë dhe po të kishte dashur ta vras A., ka mundur ta bëjë këtë pa asnjë pengesë, pasi brenda në diskotekë ka lëvizur vet, sigurimi ka qenë vetëm nëpër

pika dhe atë natë ai kishte dalë më herët sepse në fund aty të zë shërri sepse njerëzit dehen, duke shtuar se ka mundur të shtie në drejtim të A. edhe nga vetura kur ai kishte dalë nga diskoteka, dhe po të kishte dashur do ta kishte thirrur nga vetura “eja pak” ose pa e thirr kishte pasur mundësi të shtie në të sepse se me A. ishin njohur edhe jashtë diskotekës sepse një shok i tij e kishte pasur shtëpinë afër shtëpisë së A. dhe ishin njohur me A. që moti, por nuk ka pasur rast të rrinë së bashku, por kishin ndenjur në diskotekë, e aty A. kishte vendosur që ai- I. të hyj gjithmonë pa pagesë, por pijet normalisht që i ka paguar.

Në pyetjen e anëtares se trupit gjykues, Fatime Dërmaku, i akuzuari Q. ka deklaruar se armën atë ditë e kishte marrë për sherr, sepse siç thotë i akuzuari Q. “kishte dal me një dreq – një femër e cila ka qenë pak problematike, taksirati i tij, pasi ajo ka qenë shumë e bukur, provokuese, ka vallëzuar shumë, dhe kishte pasur frikën se do ta ngacmonte dikush, sepse ishte shumë e lazduar” por ai nuk kishte pasur probleme dhe herë të tjera nuk kishte mbajtur armë me vete, përkatësisht as ëndërr nuk kishte parë se do të shtie me armë drejt A., duke mohuar që atë natë armën ta ketë marrë me qëllim që me të, të shtie drejt A. sepse nuk kishte pasur qëllim të keq ndaj tij, derisa nga vetura kishte dalë vetëm për të biseduar me të.

Ndërsa në pyetjen e anëtarit të trupit gjykues, Ertan Sejfulla, i akuzuari I.B. është përgjigjur se në diskotekë ka shkuar me shokët e tij, por brenda ka ndenjur vetëm me këtë vajzën – K., të cilën atë natë A. nuk e ka ngacmuar, e për të cilën ka thënë se nuk e ka parë që nga ky rast, përkatësisht nga data 22.02.2020, duke shtuar se sigurimi zakonisht ka kryer kontroll për armë por ka pasur raste kur nuk e kanë kontrolluar dhe se në diskotekë atë natë ka pirë 6-7 birra dhe redbulla, por nuk përdorë alkool e as narkotik.

Aktgjykimi si më lart është bazuar vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç parasheh dispozita e nenit 360 të KPP, e për të cilat do të jepet vlerësimi si në vijim:

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitares A.H., është vërtetuar se natën kritike, kur e kishte kthyer kokën prapa, aty kishte parë të akuzuarin I. me allti (armë) në dorë duke shkuar në drejtim të tij larg njëri tjetrit rreth 1-1.5 metra, armën e kishte drejtuar drejt tij dhe kishte shtënë dy herë në drejtim të tij, pastaj pas të shtënës së parë ishin afruar shokët e tij- I.it, të cilët e kishin sulmuar dhe gjatë asaj kohe I. kishte shtënë për herë të dytë ku edhe e kishte plagosur, pastaj i dëmtuari ishte rrëzuar në tokë.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit D.G. është vërtetuar se ai nuk e ka njohur më parë tani të akuzuarin I.B., por të njëjtin e ka parë natën kritike të ketë shtënë tri herë me revole dhe objekt i sulmit ishte A.H..

Nga dëshmia e dëshmitarëve: R.G.; P.Sh.; G.Z.; V.T. dhe M.L. është vërtetuar se një ngjarje ka ndodhur në parkingun e Hotelit G..., në të cilën ishin përfshirë tani i akuzuari Q. me shokët e tij në njërin anë dhe tani të dëmtuarit H. e G. në anën tjetër, dhe se për këtë ata kishin kuptuar nga të pranishmit në vendin e ngjarjes pasi që personalisht nuk e kishin parë ngjarjen.

Nga CD, e administruar si provë është vërtetuar se tani i akuzuari I. i është drejtuar tani të dëmtuarit A.H. para se të ndodh ngjarja, me qëllim që t’ia rezervoj një tavolinë për të dashurën e tij dhe se në shenjë pakënaqësie i akuzuari i ishte drejtuar tani të dëmtuarit me fjalët “ok zatetemi”;

Nga rezultatet e ekzaminimit të ADN-së nga Raporti i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/2020-0678/2020-604, i datës 08.06.2020, nuk ka ndonjë rezultat e cila do të vërtetonte ndonjë fakt relevant për rastin;

Nga raporti i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë- sektori për balistikë AKF/2020-0678/2020-605, i datës 11.03.2020, është vërtetuar se arma e sekuestruar te tani i akuzuari Q., tregon llojin e armës së përdorur e cila ka qenë funksionale dhe se gëzhojat e gjetura në vend të ngjarjes janë shkrepur nga arma – pistoleta PHAG VALTER, ngjyrë e zezë më numër serik BB95366; dhe

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. N.U., i datës 04.06.2020, është vërtetuar se dëmtimet që i ka marrë i dëmtuari A.H. janë shkaktuar nga arma e zjarrit dhe të njëjtat janë lëndime të lehta trupore më pasoja të përkohshme për shëndetin, si rezultat i veprimt të mjetit mekanik jo të fortë mprehtës, ndërsa për tani të dëmtuarin D.G. nuk ka mendim të ekspertit mjeko ligjor për ndonjë lëndim, pasi i njëjti nuk është vizituar te mjeku.

Pas analizimit dhe vlerësimit të dëshmimeve të dëmtuarve, dëshmitarëve, provave materiale dhe mbrojtjes së të akuzuarit, trupi gjykues konform nenit 360, par. 2 të KPP, njëzëri ka vendosur ta bëj rikualifikimin e veprës penale pasi ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret në veprimet e tani të akuzuarit I.B. nuk përmbushen elementet e veprës penale Vrasje në tentativë, nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK, pasi që i dëmtuari në shqyrtimin gjyqësor të datës 02.06.2023 ka deklaruar se në parkingun e Hotelit G... derisa ishte duke e përcjellë shokun e tij D.G., femrën e tij dhe një vajzë tjetër, nga prapa i ka shkuar tani i akuzuari I. me revole në dorë dhe kur kanë qenë ballë për ballë njeri tjetrit rreth 1-1.5 metra tani i akuzuari ia ka drejtuar armën dhe ka shtënë dy herë drejtë tij, por e shtëna e parë nuk e ka goditur ndërsa e shtëna e dytë e ka goditur në regjionin e jashtëm të kërcirit të djathtë të këmbës, dhe se të shtënën e dytë e kishte bërë derisa ai – tani i dëmtuari A. ishte i rrëzuar në tokë. Duke vlerësuar largësinë në mes njëri tjetrit, pozitën e të dëmtuarit pas të shtënës së parë, pra i njëjti kishte qenë i rrëzuar në tokë dhe po të kishte qëllim, tani i akuzuari Q. ta vriste në këto rrethana mund ta bënte pa asnjë pengesë. Andaj, mbi këtë bazë trupi gjykues njëzëri ka vendosur që të bëhet rikualifikimi i veprës penale nga vepra penale Vrasje në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK, në veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.2 të KPRK, pasi që në veprimet e të akuzuarit Q. manifestohen të gjitha elementet e kësaj vepre penale, prandaj bazuar në thëniet si më lart është vendosur që për këtë vepër të shpallet fajtor. Po ashtu, është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprat penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 321 par. 1 të KPRK, pasi ai ka pranuar fajësinë për të njëjtat, e po ashtu edhe me prova është vërtetuar kryerja e këtyre veprave penale nga i akuzuari Q.

Pretendimet e prokurorisë dhe përfaqësueses së të dëmtuarit A.H., se tani i akuzuari Q. ka shtënë në drejtim të tani të dëmtuarit H. për ta vlarë atë, nuk janë vërtetuar me asnjë dëshmi apo provë materiale, përkatësisht prokuroria në aktakuzë pretendon se rasti ka ndodhur pas një mosmarrëveshjeve të atëçastshme në mes të tani të dëmtuarit A.H. dhe të pandehurit I.B., pa arritur të shpjegoj se për çka kishte të bënte ajo mosmarrëveshje mes tyre, përkatësisht, cili ishte motivi që tani i akuzuari ta vriste tani të dëmtuarin H. dhe pse tani i akuzuari nuk e kreu vrasjen edhe pse tani të dëmtuarin H. e kishte përballë dhe shumë afër. Po ashtu, trupi gjykues ka vlerësuar edhe afërsinë dhe pengesat në mes tani të akuzuarit dhe të dëmtuarit H., pasi ata ishin larg njëri tjetrit rreth 1-1.5 metra, i akuzuari armën e kishte drejtuar drejt tij dhe kishte shtënë një herë, pastaj një herë sipas të dëmtuarin H. dikush nga të pranishmit ia ka devijuar armën, por a e pengoi dikush tani të akuzuarin të shtënte prapë në tani të dëmtuarin H., derisa ai gjendej para tij, i shtrirë në tokë. Andaj, bazuar në thëniet si më lart, trupi gjykues ka ardhur në përfundimin se tani i akuzuari Q., nuk ka pasur për qëllim vrasjen e tani të dëmtuarit H., por vetëm lëndimin e tij, ashtu siç është paraqitur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si në vijim: kërkim faljen ndaj të dëmtuarve dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla ndaj tyre dhe motivi i kryerjes së veprës penale ka qenë për shkak të një zënke të çastit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka marrë parasysh: shkallën e lartë të pjesëmarrjes së tani të akuzuarit në kryerjen e veprës penale, përkatësisht të shtënat me armë në drejtim të të dëmtuarit A.H.; Intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht tani të dëmtuarit i janë shkaktuar lëndime të lehtë trupore nga e shtëna me armë dhe sjelljen e mëparshme të tani të akuzuarit, përkatësisht sipas të dhënave të kësaj gjykate, i njëjti ka qenë i dënuar më parë për veprat penale si në vijim: aktgjykimi P.nr.849/2005, i plotfuqishëm me datë 29.03.2013, për veprën penale Pjesëmarrja në rrahje nga neni 155 të KPRK, i dënuar me dënim me kusht me një vit burgim në afat verifikimi prej dy vite; aktgjykimi PKR.nr.659/2016, i plotfuqishëm nga data 06.03.2018, për veprën penale grabitja nga neni 329 të KPRK, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër vite e gjashtë muaj dhe dënim me gjobë 600 euro, dhe aktgjykimi P.nr.994/2007, i plotfuqishëm nga data 09.02.2009, për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 të KPRK, i dënuar me dënim me kusht prej një viti burgim në afat verifikimi prej dy vite.

Andaj, gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar atij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi që të akuzuarit t'i konfiskohet arma - sendi i përdorur për kryerjen e veprës penale, është marrë në bazë të nenit 366, par. 3 të KPRK. Ndërsa, urdhri që arma e konfiskuar të shkatërrohet ose të kaloj në shfrytëzim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, u mor konform dispozitës së nenit 277, par. 8 të KPP.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, në bazë të nenit 462, par. 1 dhe 2 të KPP, palët e dëmtuara, përmes përfaqësuesve të tyre janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1 të KPP, kurse vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të kimit u mor në bazë të neneve: 3; 6 dhe 39, par .3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Kimit.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve: 185 par. 2; 321 par. 1; dhe 366, par. 1 dhe 3 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 08.04.2024.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.905/2020, datë 29.03.2024.

Bashkëpunëtoreshë profesionale  
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues  
Naser Foniqi

**UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar (prokurori i shtetit, i akuzuari, mbrojtësi dhe të dëmtuarit me përfaqësuesit e tyre) **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.** Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.